



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 7 paragrafi 2, nenit 8, nenit 9 paragrafi 1 dhe nenit 18 të Ligjit nr.04/L-212 për Financimin e Subjekteve Politike, nenit 1 paragrafi 2, nenit 5 dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullës nr. 14/2013 Mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet, shpalljes së Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, dhe Vendimit të KQZ numër 1845-2019 për Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme të 6 tetorit 2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 19.01.2021 merr këtë :

V E N D I M

mbi Caktimin e Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për muajin janar dhe shkurt të vitit 2021

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton lartësinë e mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend sipas Rezultateve të Certifikuara me datë 27 nëntor 2019, gjegjësisht numrit të ulëseve të fituara, për financimin e aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike parlamentare dhe për mbështetjen e punës dhe aktiviteteve të secilit deputet.
- II. Shuma e mjeteve për financimin e aktiviteteve të subjekteve politike dhe për mbështetjen e punës dhe aktiviteteve të secilit deputet nga Fondi për periudhën nga 1 janar 2021 deri 28 shkurt të vitit 2021 është 700,000.00 € dhe ndahet sipas numrit të ulëseve të fituara në Kuvendin e Kosovës, për subjektet politike dhe detajeve si në vijim:

AKRONIMI	EMRI I PARTISË	Numri i vendeve të fituara	Shuma për subjektin politike në €	Shuma për aktivitete të deputetëve në €
	Lëvizja VETËVENDOSJE!	29	152250	16916.68
LDK	LIDHJA DEMOKATIKE E KOSOVES	28	147000	16333.36
PDK	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	24	126000	13999.88
	AAK-PSD KOALICIONI 100% KOSOVË	13	68250	7583.36
	NISMA SOCIALDEMOKRATE – ALEANCA KOSOVA E RE – PARTIA E DREJTËSISË	6	31500	3500.12
	SRPSKA LISTA	10	52500	5833.4
KDTP	KOSOVA DEMOKRATIK TÜRK PARTISI	2	10500	1166.64
	KOALICIJA VAKAT	2	10500	1166.64
NDS	NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	1	5250	583.32
PLE	PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE	1	5250	583.32

IRDK	INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS	1	5250	583.32
JGP	JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA	1	5250	583.32
PAI	PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	1	5250	583.32
PREBK	PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	1	5250	583.32
	Totali	120	630000	70000

- III. Për mbështetjen e punës dhe aktiviteteve të secilit deputet, Subjekti Politik ndanë mjete nga Fondi, sipas pikës II dhe në pajtim me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike.
- IV. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk autorizon asnjë shpenzim të fondeve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike që janë parapare për mbështetjen e punës dhe aktiviteteve të secilit deputet për periudhën nga data e shpalljes së zgjedhjeve të Parakoshme për Kuvendin e Kosovës, 7 janar 2021, e deri në certifikimin të rezultateve.
- V. Obligohet Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes, për zbatimin e këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Valdete Daka, Kryetare